

Nr. 1320/1478 Regj.Themeltar  
Datë Regjistrimi 09.03.2022/07.04.2022

Nr. 933 Vendimi

Datë 07.04.2022

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:  
**GJYQTAR: ARBEN MICKAJ**

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Merita Drishti**, sot më datë **07.04.2022**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen penale, që i përket:

**KËRKUESE:** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane e përfaqësuar nga prokurore **Enklid Gjini**.

**I PANDEHUR:** **Akil Berisha**, identifikuar me ane te pasaportes BR8119115, i biri i Ibrahim dhe i Hyrije, i dtl.14.08.1997, lindur ne Tropoje dhe banues ne Tirane, Rruga “Reshit Collaku”, shtetesi e kombesi shqiptare, student, beqar, i padenuar, mbrojtur me deklarim nga av. Xhemal Bajri, Dhoma e Avokatise Tirane.

**I AKUZUAR:** Për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje e lendeve narkotike”, të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.

Gjykata me vendim ka konstatuar kryesisht juridiksionin dhe kompetencën e saj si lëndore ashtu edhe tokësore për të gjykuar këtë çështje penale, dhe në bazë të neneve 69, 74 e 76/1 të K.Pr.Penale ka vendosur gjykimin e saj.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në prani të prokurorit Enklid Gjini, si dhe në prezencë të të pandehurit Akil Berisha dhe mbrojtësit të tij Av. Xhemal Bajri, gjykata dhe pasi shqyrtoi aktet dhe si dëgjoi akuzën si dhe të pandehurin së bashku me mbrojtësin, të cilët në konkluzionet përfundimtare kërkuan respektivisht:

**PROKURORI:**

- Deklarimin fajtor te pandehurit Akil Berisha per vepren penale te ”Prodhim dhe shitje e narkotikeve” parashikuar nga neni 283/1 te K.Penal dhe denimin e tij me 5(pese) vjet burgim.
- Në bazë të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e 1/3 të dënimit dhe denimin e tij me 3 (tre) vjet e 4 (kater) muaj burgim.
- Në bazë të nenit 59 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim duke e vene ne prove te pandehurin.
- Te ngarkohet i pandehuri per pagimin e shpenzimeve procedural.

**AVOKATI:**

- Kerkojme pushimin e çeshtjes per shkak se i pandehuri eshte perdorues i lendeve narkotike.
- I pandehuri ishte dakort me avokatin dhe deklaroi se eshte perdorues i lendeve narkotike.

## V Ë R E N:

Se nga Organi i Prokurorisë pranë kësaj gjykate, është sjellë për gjykim penale me Nr. 1320/1478 Akti, me datë regjistrimi 09.03.2022, në ngarkim të pandehurit Akil Berisha, akuzuar për vepren penale të “Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike” të parashikuar nga neni 283/1 të Kodit Penal.

Gjatë seancës paraprake, nga ana e të pandehurit, të asistuar nga mbrojtësi i tij, kanë kërkuar aplikimin e procedurave te procedures se gjykimit te shkurtuar, duke pranuar kryerjen e vepres penale si dhe njohur vleren e akteve, kerkese me te cilen ishte dakort edhe akuza.

Nga ana e Gjykatës në vleresimin qe u beri akteve te paraqitura nga Prokurori, ajo vendosi që gjykimi duhet zhvilluar në mbështetje të procedurave te parashikuara nga Nenet 403 - 406 te Kodit Procedures Penale duke pranuar keshtu kerkesen e te pandehurit.

Përsa i përket zhvillimit të gjykimit, Gjykata vijoi me proceduren e Gjykimit të shkurtuar, duke vijuar me shqyrtimin e provave të ndodhura dhe të administruara në fashikullin e procedimit penal Nr.6146 i vitit 2021.

Nga shqyrtimi ne teresi i provave rezultoi se:

Ne date 09.09.2021, rreth ores 18:45 ne rrugen "Myslym Shyri", Tirane, oficeret dhe agjentet e Seksionit per Hetimin e Narkotikeve, kane konstatuar shtetasin Akil Berisha se bashku me shtetasin Silvio Cela, ku shtetasi Akil Berisha eshte takuar me nje person te pidentifikuar dhe me pas ka vazhduar levizjen ne drejtim te rruges "Myslym Shyri". Pas kontrollit te ushtruar ketyre shtetasve, ka rezultuar se shtetasi Akil Berisha, iu konstatuan 6 (gjashte) qese farmaceutike, brenda se ciles ndodhej nje material i thate bimor ne ngjyre jeshile, me aroma dhe karakteristika, si ajo e lende se dyshuar narkotike te llojit cannabis sativa.

Eshte bere peshimi i lendes se dyshuar narkotike cannabis sativa qe ju gjet shtetasit Akil Berisha dhe rezultoi me peshe totale me ambalazh 7.4 (shtate pike kater )grame, e cila eshte derguar per ekspertim kimik prane IPSH. I eshte marre kampioni i urines shtetasit Akil Berisha dhe eshte derguar per ekspertim prane IML-se.

Eshte pyetur ne cilesine ndaj te cilit zhvillohen hetimet shtetasi Akil Berisha, i cili ka deklaruar se ka qene duke shkuar per ne shtepi se bashku me shokun e tij shtetasin Silvio Cela dhe ne nje moment kur ka qene ne rrugen "Myslym Shyri" afer karburant "Kastrati", i ka thene shtetasit Silvio Cela, ta prese ne rruge dhe ka shkuar te takoje nje person per te blere lende narkotike. Me pas shtetasi Akil Berisha ka pohuar se lenden narkotike e ka blere tek nje djale i moshes rreth 20 vjec, emrin e te cilit nuk e di, por i ka nje numer celulari dhe se e ka shenuar pa emer. Shtetasi Akil Berisha gjate deklarimit ka identifikuar numrin e celularit 0676805545 qe i perket personit ku ka blere lende narkotike.

Eshte pyetur ne cilesine e personit ndaj te cilit zhvillohen hetimet shtetasi Silvio Cela, i cili ka deklaruar se ka qene ne shoqerine e shtetasit Akil Berisha dhe ka qene duke shkuar per ne shtepi, kur shtetasi Akil Berisha ka ndaluar ne rrugen "Myslym Shyri" afer karburant "Kastrati" per te takuar nje person dhe me pas ka vijuar rrugen per ne shtepi. Ne vijim shtetasi Silvio Cela ka deklaruar, se nuk kishte dijeni per lenden narkotike qe shtetasi Akil Berisha kishte me vete.

Në lidhje me këtë ngjarje janë kryer të gjitha veprimet proceduriale si dhe janë përpiluar të gjitha vendimet e ekspertimit përkatës.

Është administruar Akti i ekspertimit kimik Nr.11379, date 08.11.2021, ku është arritur në konkluzionin se:

1. Materialet bimore objekt ekspertimi është cannabis product herbal bime cannabis sativa L.
2. Pesha e materialeve bimore pa ambalazh në total është 6.401(gjashte pike katerqind e nje) grame.

Sipas Aktit të ekspertimit toksikologjiko-ligjor nr.2404 date 28.09.2021, është arritur në konkluzionin se në mostrën e urinës të marre shtetasit Akil Berisha, mbyllur në kontener dhe të futur në qese prove me Nr. B20006529, u zbulua prania e produkteve kanabinoidike të metabolizmit të bimes cannabis sativa L në organizimin e njeriut.

Sipas Aktit të ekspertimit mjeko-ligjor (klinikist) Nr. 147 date 20.01.2022 në ngarkim të shtetasit Akil Berisha rezultoi se :

1- Ndarja e lëndës narkotike me doza nuk është objekt i ekspertimit mjeko ligjor. Dozat e helmimit akut fillojnë kur vlera e THC, është në masën nga 20-30 miligram dhe shkon deri në 100 miligram. Në rastin konkret sasia prej 6.401 grame cannabis sativa ku vlerat THC është 640 miligram nuk konsiderohet si doze e vogël për përdorim vetjak një përdorimesh apo dhe ditor, pasi përdorimi i saj do të shkaktojte dëmtime për shëndetin.

Vepra penale e "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve", (neni 283/1 i K.Penal) parashikon se: *"Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregëtimi, transportimi, dërgimi, dorezimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe i farërave të bimeve narkotike, në kundërshtim me ligjin, ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet."*

Nisur nga ky formulim, ku pasi renditen format se si kryhet kjo vepër nga ana objektive, ligjvënësi bën një dallim për sa i përket penalizimit, lidhur me formën e mbajtjes. Kështu mbajtja e lëndës narkotike për qëllim shitje është një veprim penalisht i dënueshëm, ndërsa rasti i mbajtjes për përdorim personal *"përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope"*, nuk përbën vepër penale. Ky dallim është mjaft i rëndësishëm dhe vjen si rezultat i analizës së rrethanave të faktit, e cila kërkon rast pas rast edhe një vlerësim të mbajtjes në potencë për shitje, me qëllim që subjektet që kryejnë vepër penale të mos i shpëtojnë përgjegjësisë penale. Për këtë arsye, ligjvënësi ka vendosur kriterin e mbajtjes në doza të vogla. Në mënyrë të qartë, kodi penal i ka përjashtuar nga përgjegjësia penale të gjithë përdoruesit e lëndës narkotike, por me kufizimin që mbajtja e lëndës narkotike dhe psikotrope prej tyre të jetë në doza të vogla. Pra, përjashtimi nga përgjegjësia penale i kërkon në mënyrë kumulative përdorimin vetjak dhe në doza të vogla.

Prokurori ka konkluduar se, nga provat e administruara në hetim rezultoi se provuar se sasia e lëndës narkotike që ka pasur në posedim personi nën hetim Akil Berisha është 6.401 grame e llojit cannabis sativa, e cila kërkoi në radhë të parë një vlerësim të kriterit sasior, i cili në mungesë të një akti referues ligjor duhet t'i referohet një Akti ekspertimi toksikologjik mbi kapacitetin absorbues fizik të subjektit përdorues të lëndës narkotike apo psikotrope.

Gjatë hetimit u provua, konkretisht me Aktin e ekspertimit toksikologjik-klinikist se sasia prej 6.401 grame e lëndës narkotike e llojit cannabis sativa, që i është kapur të pandehurit Akil Berisha, nuk konsiderohet si doze e vogël për përdorim vetjak njëpërdorimesh apo dhe ditor, pasi përdorimi i saj do të shkaktojte dëmtime për shëndetin.

Si përfundim, nisur nga analiza e të gjitha provave të administruara në hetim u provua se shtetasi Akil Berisha, ka mbajtur në kundërshtim me ligjin një sasi lënde narkotike të llojit

cannabis sativa, e cila duke u nisur nga sasia dhe nga ekspertimi toksikologji -klinikist, tregon qartë se nuk është dozë e vogël për përdorim vetjak, sipas përcaktimeve që parashikon dispozita penale e Neni 283/1 të K.Penal dhe vendimi unifikues Nr.1, datë 27.03.2008 i Gjykatës së Lartë.

Përsa më sipër, prokurorja ka konkluduar se i pandehuri Akil Berisha, ka konsumuar veprën penale “Prodhim e shitje të lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 283/1 të Kodit Penal.

Akuza ndaj te pandehurit Akil Berisha, u provua dhe nga administrimi në seancë gjyqësore të provave shkresore: Procesverbal i kapjes në flagrance; Procesverbalin e sekuestrimit të sendeve; Procesverbali i kontrollit të banesës;Aktet e ekspertimit mjekoligjor e kimik të lëndës; Procesverbalet e deklarimeve të shtetasit Silvo Cela; Akil Berisha, si dhe në teresi materialet që ndodhen në dosjen hetimore nr. 6146 të vitit 2021.

**Në lidhje me nenin 283/1 të K.Penal:**

*“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet”.*

**Objekti** i kësaj veprë penale është mbrojtja e marrëdhënieve juridike të vendosura për të garantuar rendin dhe sigurinë publike nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Konkretisht veprimet e kundraligjshme të kryera nga i pandehuri Akil Berisha, kanë cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura me Ligjin Nr.7975, date 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe psikotrope”, për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, veçanërisht jetën dhe shëndetin e personit, regjimin juridik për shitjen, dhënien, marrjen dhe mbajtjen e substancave narkotike dhe psikotrope, të mbrojtura me legjislacionin tonë penal nga veprimet apo mosveprimet kriminale.

**Nga ana objektive** kjo veprë penale është konsumuar nga i pandehuri Akil Berisha dhe se veprimet e kunderligjshme janë manifestuar në formën e mbajtjes, nisur nga fakti se gjatë kontrollit fizik të ushtruar ndaj tij nga ana e efektivëve të policisë janë gjetur kater qese farmaceutike, brenda të cilës sipas aktit të ekspertimit të lëndës, përmban lëndë narkotike cannabis sativa. Sasia e mësipërme, e cila ka një peshë jo të vogël dhe e ndarë në gjashtë doza, nënkupton që nuk është sasi për përdorim vetjak.

**Ana subjektive** e veprës penale realizohet me dashje direkte. I pandehuri nga tërësia e rrethanave të faktit dhe objektit të marrëdhënies juridike nuk mund të mos pranohet dijenia që veprimet e tij bien ndesh me urdhëresat e ligjit. Ai ka parashikuar që me veprimet e tij konsumon elementët e një veprë penale.

**Subjekti** i kësaj veprës penale duhet të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale për krime dhe duhet të mos ekzistojnë shkaqe për përjashtim nga përgjegjësia penale të të pandehurit. Nga tërësia e akteve rezulton se i pandehuri gjenden si subjekt i veprës penale.

Në caktimin e llojit dhe masën e dënimit gjykata duhet të ketë parasysh këto rrethana të vërtetuara gjatë gjykimit.

- Rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të “Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, për të cilën ligjvënësi ka parashikuar një masë dënimi nga pesë vjet deri në dhjetë vjet burgim.
- Faktin që i pandehuri nuk ka qënë penalisht i dënuar më parë.
- Fakti që i pandehuri është përdorues i lëndës narkotike.

**Referuar, analizes juridike si me sipër, Gjykata** vlereson se për shkak të bindjes së saj të krijuar mbi provat e administruara në gjykim mbi implikueshmërinë e plote të të pandehurit Akil

Berisha, në veprimtarinë e kundërligjshme të lidhur me mbajtjen e lëndës narkotike të sekuestruar, të analizuar më sipër, në rastin konkret vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri, është kualifikuar drejt nga organi i akuzës sipas çilesimit të duhur juridik, të konkluduar nga konsumimi plotësisht prej të pandehurit i të gjithë elementeve të figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.

Sa më sipër gjykata duke u bazuar në nenin 291 të Kodit Penal çmon se i pandehuri Akil Berisha duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të “**Prodhimi dhe shitja e narkotikeve**”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 5 (pese) vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale i ulët 1/3 e dënimit duke e dënuar me 3 (tre) vjet e 4 (kater) burgim.

Gjykata në zbatim të nenit 59 të K.Penal, vendosi pezullimin e dënimit me burgim me një afat prej 2 (dy) vjetësh me kusht që i pandehuri të mos kryej vepra tjeter penale dhe detyrimin e të pandehurit për tu paraqitur pranë Sherbimit të Proves.

Gjykata çmon se ky lloj dhe kjo masë dënimi është në përshtatje me rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit si dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale.

Duke qënë se i pandehuri Akil Berisha u deklarua fajtor dhe u dënua për veprën penale për të cilën akuzohet bazuar në nenin 485 të K.Pr.Penale i pandehuri duhet të paguajë shpenzimet procedurale gjatë hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga shteti.

Për sa u analizua u provua me pretendimet e palëve në seancë dhe aktet e ndodhura në dosje pjesë përbërëse e fashikullit gjyqësor.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

**Gjykata bazuar në nenet: 47, 48, 49, 51, 59, 283/1 të K.Penal,**

**190, 217, 380, 381, 382, 383, 384, 390, 393, 403-406 të K.Pr.Penale:**

#### **V E N D O S I:**

- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Akil Ibrahim Berisha** për veprën penale të “**Prodhimi dhe shitja e narkotikeve**”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe dënimi i tij me **5(pese) vjet burgim**.
- Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e 1/3 së këtij dënimi dhe dënimin përfundimisht të të pandehurit **Akil Ibrahim Berisha** me **3(tre) vjet e 4(kater) muaj burgim**.
- Në zbatim të nenit 59 të K.Penal, pezullimin e dënimit me burgim me një afat prej 2(dy) vjetësh me kusht që i pandehuri të mos kryej vepra tjeter penale dhe detyrimin e tij për tu paraqitur pranë Sherbimit të Proves.
- Shpenzimet procedurale i ngarkohen të pandehurit.
- Kunder këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.
- **U shpall sot, me 07.04.2022.**

**SEKRETARE  
MERITA DRISHTI**

**G J Y Q T A R  
ARBEN MICKAJ**

**Hetimet paraprake 15 000 leke**  
**Njoftime 2x150 leke**